



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-102

PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1(f), dhe 9.1.26(a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë (Rreg.e UNMIK-ut 2001/9, datë 15 maj 2001) si dhe duke parë nevojën e harmonizimit të standardeve mjedisore të Kosovës me ato të Bashkimit Evropian;

Miraton:

LIGJIN PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME
Qëllimi dhe fushëveprimi

Neni 1

Qëllimi

1.1. Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis.

1.2. Ky ligj do të ofrojë bazë për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma.

Neni 2

Fushëveprimi

2.1. Zhurma e dëmshme për shëndetin e njeriut nga ky ligj, është çdo zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara, të cilat do të përcaktohen me akt të veçantë normativ, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendit ku buron zhurma, në mesin ku njerëzit punojnë dhe jetojnë.

2.2. Ky ligj do të zbatohet për zhurmën mjedisore ndaj të cilës njerëzit ekspozohen në zonat e ndërtuara, “zonat e veçanta të planit hapësinor”, në parqet publike ose zonat tjera të qeta të aglomerateve, zonat e qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve, zonave dhe ndërtesave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës.

2.3. Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me masat mbrojtëse nga zhurma të cilat e detyrojnë Kosovën, sipas kontratave ndërkombëtare, konventave dhe normave tjera në transportin ajror, hekurudhor, dhe atë rrugor.

2.4. Aktin nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni, e nxjerr ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me pëlqimin paraprak të ministrit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ministrit të Ministrisë për Shëndetësi.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji, shprehjet në vijim do të kenë këto kuptime:

“**Zhurma mjedisore**”- zërat e jashtëm të padëshirueshëm ose të dëmshëm, të krijuar nga aktivitetet njerëzore, duke përfshirë edhe zhurmën e emetuar nga mjetet e transportit, trafikut rrugor, trafikut ajror dhe nga vendet e aktiviteteve industriale, që janë subjekt lejes së Parandalimit të Integruar të Ndotjes dhe Kontrolli (PINK-IPPC).

“**Efektet e dëmshme**” - ndikimet negative për shëndetin e njeriut.

“**Bezdisje**” - shkalla e bezdisjes së komunitetit nga zhurma, e përcaktuar në bazë të shqyrtimeve në terren.

“**Indikator i zhurmës**” - shkalla fizike që përshkruan zhurmën mjedisore e cila ka të bëjë me ndikimet e dëmshme.

“**Vlerësim**” - çdo metodë që përdoret për llogaritje, parashikim, vlerësim apo matje të vlerës së indikatorit të zhurmës ose ndikimeve negative.

“**Ldmn**” (indikator i zhurmës ditë-mbrëmje-natë) – indikator i zhurmës së përgjithshme bezdisëse (dita ka 12 orë, mbrëmja 3 orë dhe nata 9 orë).

“**Lditë**” (indikator i zhurmës-ditë) – indikator i zhurmës bezdisëse gjatë ditës (mesatarja afatgjate e nivelit të zërit sipas standardeve ISO 1996-2:1987, përcaktuar gjatë gjithë periudhave ditore të vitit).

“**Lmbrëmje**” (indikator i zhurmës-mbrëmje) - indikator i zhurmës bezdisëse gjatë kohës së mbrëmjes (mesatarja afatgjate e nivelit të zërit sipas standardeve ISO 1996-2:1987, përcaktuar gjatë gjithë periudhave të mbrëmjes në vit)

“**Lnatë**” (indikator i zhurmës-gjatë natës) – indikator i zhurmës që prish gjumin (mesatarja afatgjate e nivelit të zërit sipas standardeve ISO 1996-2:1987, përcaktuar gjatë gjithë periudhave të natës në vit).

“**Relacioni dozë-ndikim**” - relacion në mes të vlerës së indikatorit të zhurmës dhe ndikimit negativ.

“Agglomerate (vendbanime)” – pjesë e territorit të përkufizuar nga shteti që ka një popullatë prej më tepër se 100.000 banorë dhe dendësi të popullsisë në atë mënyrë që shteti e përkufizon atë si zonë e urbanizuar.

“Zonë e qetë në aglomerat” – zonë e përkufizuar nga autoriteti kompetent, e cila prej çfarëdo burimi të ndotjes, nuk i ekspozohet vlerës së Ldmn-së ose ndonjë indikator tjetër më të madh të zhurmës, se sa vlerat e qarta të përcaktuara nga Qeveria.

“Qeveria” - qeverinë siç është specifikuar në Rregulloren e UNIMK 2001/19, mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës.

“Zonë e qetë në vendet e hapura”- zonë e përkufizuar nga autoriteti kompetent që nuk shqetësohet nga zhurma e trafikut, industria ose aktivitetet rekreative.

“Rrugë kryesore” – rrugë rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare e përcaktuar nga shteti në të cilën kalojnë më tepër se tre milion automjete në vit.

“Hekurudhë kryesore” – hekurudhë e përcaktuar nga Qeveria, në të cilën kalojnë më tepër se 30.000 trena në vit.

“Aeroport i madh” - aeroport civil i përcaktuar nga Shteti, që ka më tepër se 50.000 lëvizje në vit (lëvizje është ngritja dhe zbritja), me përjashtim të aeroplanëve për qëllime trajnimi.

“Ministria” - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor .

“Vënia e zhurmës në harta” - paraqitja e të dhënave ekzistuese ose të paraparë të zhurmës, indikatorit të zhurmës, tejkalinimit e çdo vlere kufitare relevante në fuqi, numrin e njerëzve që ndikohet në zonat e caktuara ose numrin e shtëpive të ekspozuara ndaj vlerave të caktuara të indikatorit të zhurmës në zonat e caktuara.

“Harta strategjike për zhurmë” - hartë e dizajnuar për vlerësimin global të ekspozimit ndaj zhurmës në zonën e caktuar si rezultat i burimeve të ndryshme të zhurmës ose për parashikimin e përgjithshëm për një zonë të tillë.

“Vlerë kufitare”- vlere e Ldmn ose Lnatë dhe kur është e duhur Lditë dhe Lmbrëmje, siç e përcakton Ministria, tejkalimi i së cilës bën që autoritetet kompetente të ndërmarrin ose zbatojnë masa për zbutje. Vlertat kufitare mund të jetë e ndryshme për llojet e ndryshme të zhurmës (zhurma nga rrugët, hekurudha, trafiku ajror, industrial etj.), rrethe të ndryshme dhe ndjeshmëri të ndryshme të popullatës ndaj zhurmës: ato po ashtu mund të jenë të ndryshme për situatat ekzistuese dhe për zgjidhje të reja (kur ka ndryshime të situatës lidhur me burimin e zhurmës ose shfrytëzimin e rrethinës).

“Plan i veprimit” – plan i hartuar për menaxhimin e çështjeve dhe ndikimeve nga zhurma, përfshirë edhe zvogëlimin e zhurmës nëse është e nevojshme.

“Planifikimi i akustikës” - kontrolli i zhurmës në të ardhmen përmes planifikimit të masave, siç janë planifikimi i shfrytëzimit të tokës, sistemet e inxhinjeruara për trafik, planifikimi i trafikut, ulja e nivelit të zhurmës përmes izolimit të zërit si dhe kontrollit të burimeve të zhurmës.

“Publiku”- një apo më tepër persona fizik apo juridik që kanë të drejtë të përgjithshme të informohen mbi çështjet mjedisore sipas Ligjit të Kosovës mbi Lirinë e Informimit.

“Objekte speciale të mbrojtura” - shkollat, spitalet, ndërtesat tjera të ndjeshme ndaj zhurmës si dhe zonat të cilat i cakton komuna.

“Plan hapësinor për zona speciale” - zonat përreth objekteve speciale për mbrojtje ku kërkohen nivele më të ulëta të zhurmës.

“Qytet” – vendbanim i njerëzve i shpallur nga Kuvendi Komunal, duke marrë parasysh nivelet e aktiviteteve të ndërtimit dhe karakteristikat tjera të natyrës urbane.

“Zonë urbane” - toka me kufij të caktuar brenda së cilës është planifikuar zhvillimi urban.

“Kufiri i ndërtimit” - vijë kufitare e cila përcakton se ku lejohet ndërtimi i ndërtesave të ndjeshme ndaj zhurmës.

“Objektet dhe zonat ekzistuese” – objektet dhe zonat që ekzistojnë fizikisht, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

“Zhvillimet e reja” – objektet dhe zonat që nuk janë të kompletuara, apo nuk ekzistojnë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

“Burime të zhurmës” – çdo vibracion i detektueshëm nga veshi i njeriut, i shkaktuar nga ndonjë mjet apo aktivitet i njeriut.

“Emitimi” - sasia e zhurmës së krijuar nga një burim në distancë të caktuar;

“Imisioni” - niveli i zhurmës së matur apo të kalkuluar në objekte të veçanta, në planin hapësinor dhe në zona të veçanta;

“Organi kompetent” – organ i cili me akt normativ të ministrisë është i autorizuar që të kryej një apo disa punë të caktuara.

KREU II

Masat mbrojtëse

Neni 4

4.1. Me masat e mbrojtjes nga zhurma, patjetër duhet të pengohet paraqitja e zhurmës, respektivisht të zvogëlohet zhurma ekzistuese në nivel optimal.

4.2. Masat e mbrojtjes nga zhurma përmbajnë:

- a) Përzgjedhjen dhe përdorimin e makinave, pajisjeve, mjeteve të punës dhe të transportit të cilat nuk shkaktjnë zhurmë mbi nivelin e lejuar;
- b) Vendosjen e objekteve me burim zhurme dhe zonat ose objektet të cilat duhet mbrojtur nga zhurma;
- c) Izolimimin për mbrojtje nga zhurma të ndërtesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës, në hapësirat e punës ose banimit;
- d) Përdorimin e masave për mbrojtje nga zhurma, në bazë të llogaritjeve dhe matjeve të zhurmës në vendin e emisionit, rrugët e zgjerimit të zhurmës etj;
- e) Matjet me qëllim të përcjelljeve dhe mbikëqyrjes së përhershme të zhurmës;
- f) Kufizimet e herëpashershme të emitimit të zhurmës.

Neni 5

Mbrojtja nga zhurma dhe sigurimi i zbatueshmërisë së sajë është detyrë e institucioneve qendrore, njësisive lokale, personave fizik e juridik dhe qytetarëve.

Neni 6

6.1. Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën.

6.2. Në kuptim të këtij ligji, dita zgjat 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00, mbrëmja zgjat 3 orë dhe fillon nga ora 19:00 deri në ora 22:00, kurse nata zgjat 9 orë dhe fillon nga ora 22:00 deri në ora 07:00 në mëngjes.

Neni 7

7.1. Makinat, mjetet transportuese, pajisjet dhe aparatet të cilat prodhohen në Kosovë ose importohen në Kosovë, para përdorimit të tyre, duhet të jenë në harmoni me rregullat dhe kërkesat teknike të cilat i dedikohen nivelit të lejuar të zhurmës të cilën ato e prodhojnë nën kushte të caktuara të përdorimit. Detyrimisht duhet të kenë shënime në dokumentin përcjellës, për nivelin e zhurmës i cili duhet të jetë në përputhje me normat e Kosovës ose normat e Bashkimit Evropian (BE).

7.2. Burimi i zhurmës nga makinat, mjetet transportuese, pajisjet dhe aparatet nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat janë në përdorim dhe për të cilët nuk ka shënime për nivelin e zhurmës se emituar, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, duhet përshtatur me dispozitat e këtij ligji, në afat prej 5 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

8.1. Dokumentet dhe aktet për zbatimin e rregullimit hapësinor të të gjitha niveleve, duhet patjetër të përmbajnë masa adekuate për mbrojtjen nga zhurma.

8.2. Përmbajtjen e bazës profesionale nga aspekti i mbrojtjes nga zhurma e cila përdoret për hartimin e dokumenteve për rregullim hapësinor nga paragrafi 1 i këtij neni me akt të veçantë normativ e përcakton Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

KREU III

Dokumentet për mbrojtjen nga zhurma

Neni 9

9.1. Qeveria dhe komunat duhet të hartojnë:

- a) Hartën strategjike të zhurmës;
- b) Planin e veprimit.

9.2. Hartat strategjike të zhurmës nga paragrafi 1 i këtij neni janë pjesë përbërëse e sistemit informativ të mbrojtjes së mjedisit të Kosovës dhe paraqesin bazë profesionale për hartimin e planeve hapësinore.

9.3. Ministria duhet që në Planin e Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit, të përfshijë hartën strategjike të zhurmës dhe planin e veprimit duke paraqitur situatën për vitin e ardhshëm kalendarik dhe masat e ndërmarra në mjedis, për të gjitha aglomeratet dhe për të gjitha rrugët kryesore, brenda territorit.

9.4. Harta strategjike e zhurmës dhe plani i veprimit aprovohen nga organet kompetente.

9.5. Hartat strategjike të zhurmës duhet të përmbushin kushtet minimale, të cilat do të paraqiten në një udhëzues, të përgatitur nga Ministria.

9.6. Hartat strategjike e zhurmës do të korrigjohen sipas nevojës, së paku çdo pesë vjet pas përgatitjes së tyre.

KREU IV

Detyrat dhe përgjegjësit e organeve, personave juridik dhe fizik

Neni 10

Në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) duhet të përfshihet edhe vlerësimi i nivelit të zhurmës dhe masat për mbrojtjen nga zhurma.

Neni 11

Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij itenziteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit për Ndërtimin.

Neni 12

12.1. Për ndërtim të objektit, për procedurën e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe procedurën e kontrollit teknik ose për rikonstruimin e objektit, në procedurën e lejes së përdorimit, komisioni kompetent për pranim teknik jep mendimin mbi masat të cilat aplikohen për mbrojtjen nga zhurma në kuadër të kompetencave që i ka.

12.2. Shpenzimet e procedurës për përcaktimin e masave të zbatuara për mbrojtjen nga zhurma i bart investitori i objektit.

Neni 13

13.1. Organi kompetent për përcaktimin e kushteve minimale teknike dhe kushteve tjera, për kryerjen e veprimtarive, nuk mund të lëshojë vendim për plotësimin e kushteve të lartpërmendura, nëse organi kompetent për inspektim mjedisor, me vendim, nuk vërteton se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma.

13.2. Shpenzimet mbi masat e hartuara për mbrojtjen nga zhurma dhe shpenzimet e kësaj veprimtarie, i bartë parashtruesi i kërkesës.

Neni 14

14.1. Burimet e zhurmës të cilat janë në përdorim të përkohëshëm ose të cilat vendosën në vende të hapura mbi nivel të tokës, në mure ose mbi pullaze të ndërtesave, në objekte të levizëshme ose të palëvizshme ose të cilat përdoren në ajër, duhet t'i përmbajnë shënimet mbi fuqinë dhe itenzitetin e zërit.

14.2. Burimet e zhurmës nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të përdoren nëse organi kompetent – inspektorati për mjedis, me vendim përcakton se zhurma nga burimi, nuk tejkalon nivelin e lejuar në mjedis.

14.3. Në rast se burimi i zhurmës emiton:

- a) nivel më të lartë të zhurmës se sa ai i lejuar, atëherë pronari i burimit të zhurmës i bartë shpenzimet e matjeve;
- b) nivel më të ulët të zhurmës se sa ai i lejuar, atëherë organi kompetent i bartë shpenzimet e matjeve.

Neni 15

15.1. Me rastin e plotësimit të nevojave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla.

15.2. Me të njëjtin vendim përcaktohen edhe rrugët e shkuarjes e ardhjes të pjesëmarrësve nga këto manifestime.

Neni 16

16.1. Ndalohet kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera, në mënyrë që me zhurmë pengohet qetësia dhe pushimi i njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga ora 22:00 – 07:00.

16.2. Në vendbanime lejohet degjimi i zërit të zileve ose pajisjeve elektroakustike nga ora 07:00 – 22:00.

16.3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bën zërimi i zilës ose pajisjeve elektroakustike, në kohën e riteve fetare si dhe në ditët e festave.

Neni 17

Dispozitat e këtij ligji, nuk vlejné për zhurmën e cila shkaktohet gjatë eliminimit të pasojave të fatkeqësive natyrore ose në raste dhe rrethana të jashtëzakonshme të cilat mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme materiale, rrezikojné shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe rrënojnë mjedisin e njeriut në përmasa të mëdha.

KREU V

Përsonat e autorizuar për kryerjen e veprimtarive profesionale për mbrojtjen nga zhurma

Neni 18

18.1. Punët profesionale të mbrojtjes nga zhurma mund t'i kryejné personat juridik të regjistruar për kryerjen e këtyre veprimtarive dhe të cilët kanë autorizim nga Ministria.

18.2. Ministri në bashkëpunim me ministrin e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale me akt plotësues normativ përcakton kushtet për kryerjen e veprimtarive si dhe mbikqyrjen profesionale mbi personat juridik në fushën e mbrojtjes nga zhurma.

18.3. Me Vendim administrativ, Ministri i autorizon personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa, por mund të inicohet kontesti administrative në bazë të vërtetimit të lëshuar paraprakisht nga Instituti gjegjës për normime dhe matje.

18.4. Shpenzimet mbi përcaktimin e kushteve nga paragrafi 2 i këtij neni i bartë parashtruesi i kërkesës.

Neni 19

19.1. Përsonat të cilët kryejné punë profesionale për përsonat juridik nga lëmia e mbrojtjes nga zhurma, duhet ta kenë të dhenë provimin profesional.

19.2. Provimi profesional nga paragrafi 1 i këtij neni organizohet dhe mbahet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por punët lidhur me dhënien e këtij provimi mund t'i bartë të një person tjetër i autorizuar juridik.

19.3. Programin, kushtet dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional e nxjerr ministri i Ministrisë me mendim paraprak të ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me akt nenligjor.

Neni 20

20.1. Përsonat nga neni 18 dhe 19 të këtij ligji, detyrohen që për mënyrën e procedurës së matjeve llogaritëse si dhe vlerësimin dhe përmbajtjen e rezultateve të matjeve t'i respektojnë normat e Kosovës, dhe direktivat e BE.

20.2. Nëse me mbikqyrjen profesionale vërtetohet se personi i autorizuar nga neni 19 paragrafi 1 i këtij ligji, nuk i kryen punët profesionale, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Ministri e anulon autorizimin përkatës.

Neni 21

Autorizimi i Ministrit për personat që kryejnë punë profesionale nga lëmia e mbrojtjes nga zhurma nga neni 18 paragrafi 1 i këtij ligji, duhet të shpallet në gazetën zyrtare të IPVQ-vë.

KREU VI Mbikëqyrja

Neni 22

22.1. Mbikëqyrjen, për aplikimin e këtij ligji dhe të akteve plotësuese normative që dalin nga ky ligj, e kryejnë inspektorët e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe inspektorët komunal të mjedisit.

22.2. Mbikëqyrja për dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen zhurmës në hapësira ku punohet, ku gjatë procesit të punës shkaktohet zhurmë si dhe në dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen qarkullimit të makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve, fuqisë së zërimit që emitohet nga to, në kushte të përcaktuara, kryhet nga inspektorët e inspektoratit të mjedisit.

Neni 23

23.1. Organet kompetente mbikëqyrëse që kryejnë këto veprime nga neni 22 paragrafi 1 i këtij ligji, janë të autorizuar që në vendin e ngjarjes t'i ndërmarrin të gjitha masat nga neni 24 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) e këtij ligji, në raste kur emisioni i zhurmës tejkalon nivelin më të lartë të lejuar nga neni 2 i këtij ligji, në bazë të rezultateve matëse.

23.2. Organet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të bëjnë kufizime ose përkohësisht të ndalojnë kryerjen e veprimtarisë së caktuar personit juridik ose fizik me urdhëresë, në kohëzgjatje më së shumti prej 8 ditësh.

23.3. Urdhëresa nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të ekzekutohet menjëherë, me vulosjen e aparatit, pajisjes ose makinerisë ose në një menyrë tjetër të përshtatshme, kur me matje konstatohet tejkalimi i nivelit të zhurmës, në harmoni me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 24

24.1. Organi kompetent i mbikëqyrjes nga neni 23 paragrafi 1 i këtij ligji është i autorizuar:

- a) Të urdhëroj personat juridik ose fizik të cilët e përdorin burimin e zhurmës në mjedise ku njerëzit banojnë ose jetojnë, që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës;
- b) Të urdhëroj ndërmarrjen e masave nga rregullativa e caktuar mbi mbrojtjen nga zhurma;
- c) Të ndaloj përdorimin e ndërtesës së ndërtuar ose të projektuar, nëse nuk janë ndërmarrë masa për mbrojtjen nga zhurma, deri sa këto masa nuk aplikohen;
- d) Të ndaloj përdorimin e burimit të zhurmës deri sa nuk ndërmirren masa për mbrojtje nga zhurma;

- e) Të ndaloj kryerjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të tjera të cilat për arsye të zhurmës pengojnë pushimin dhe qetësinë e natës, nese kjo nuk është e mundur të pengohet me masa nga pika (d) e këtij neni;
- f) Të ndaloj përdorimin e makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve të cilat nuk kanë evidence për forcën e zhurmës që emitohet në kushte të caktuara të përdorimit;
- g) Të ndaloj kryerjen e veprimtarisë ose aktiviteteve të tjera, nëse e njejta fillon punën pa një vendim të organit kompetent në të cilin përcaktohen masat mbi mbrojtjen nga zhurma.

24.2. Organet, nga neni 23 paragrafi 2 i këtij ligji, autorizohen që t'i ndërmarrin të gjitha masat sipas rregullave të posaçme.

KREU VII Dispozitat ndëshkuese

Neni 25

25.1. Me gjobë në vlerë prej 500 – 10.000 €, do të gjobitet për kundërvajtje personi juridik nëse:

- a) Shkakton që niveli i zhurmës së cilës i ekspozohen njerëzit në mjediset ku jetojnë, t'i tejkaloj kufijtë e lejuar në nenin 2 të këtij ligji;
- b) Nuk lejon kryerjen e matjeve të zhurmës nga ana e personit të autorizuar zyrtar sipas nenit 4 të këtij ligji;
- c) Përdoren makinat, mjetet transportuese, pajisjet dhe aparatet në qarkullim, respektivisht në përdorim, pa shenime mbi forcën e zërit sipas nenit 7 të këtij ligji;
- d) Fillon kryerjen e veprimtarisë ose aktiviteteve të tjera, pa vendim të organit kompetent, me të cilin përcaktohet se janë kryer të gjitha masat për mbrojtje nga zhurma;
- e) Shfrytëzon burimet e zhurmës në vende të hapura, pa vendim të organit kompetent sipas nenit 13 të këtij ligji;
- f) Kryen punime, veprime dhe aktivitete tjera, me të cilat pengon qetësinë dhe pushimin e njerëzve në hapsirë të mbyllur ose të hapur në vendet ku ata jetojnë;
- g) Matjet i kryen personi i cili nuk e ka të dhenë provimin profesional;
- h) Matja e zhurmës, llogaritja dhe vlerësimi nuk kryhen sipas nenit 20 të këtij ligji;
- i) Të dhënat nga matjet e zhurmës nuk janë në përputhje me nenin 20 të këtij ligji;
- j) Nuk ndërmerr masa nga rregullorja ose nga urdhërat për mbrojtje nga zhurma sipas nenit 23 të këtij ligji.

25.2. Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni, gjobitet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës i personit juridik, me gjobë në vlerë prej 100 – 1000 €.

KREU VIII
Dispozitat kalimtare

Neni 26

26.1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, Ministri i nxjerr në afat prej 12 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

26.2. Qeveria dhe komunat detyrohen që hartat e zhurmës nga neni 9 i këtij ligji t'i aprovojnë dhe fuqizojnë në afat prej 3 vjetësh, ndërsa planet e veprimit në afat prej 5 vjetësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen ligjet tjera që kanë rregulluar këtë fushë.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-102
30 mars 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha